

Mars 2025 | Nr. 47

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD\_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**METANI: PRAKTIKAT E MIRA TE VETTINGUT DUHET T'I SHËRBEJNË KONSOLIDIMIT TË STANDARDEVE TË DREJTËSISË**





## METANI: PRAKTIKAT E MIRA TE VETTINGUT DUHET T'I SHËRBEJNË KONSOLIDIMIT TË STANDARDEVE TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Procesi i vettingut dhe efektet e tij drejt një gjyqësori të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm në Shqipëri”, bashkë me drejtues e përfaqësues të institucioneve të drejtësisë e jo vetëm, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Lartë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Avokati i Popullit, organizata të Shoqërisë Civile etj dhe Ambasadorin e Bashkimit Evropian dhe Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Takimi u organizua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), që paraqiti Dokumentin e Politikave në lidhje me vazhdimin dhe konsolidimin e procesit të vettingut në Shqipëri me mbështetjen e Platformës së Grupkapitullit 1.

Në fjalën e tij z. Metani tha mes të tjerash se “Që prej ngritjes së organeve të reformuara të drejtësisë dhe në vazhdim, proceset e rekrutimit, karrierës dhe llogaridhënies së magjistratëve po implementohen nga këto organe, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, që i rregullojnë ato. Veç këtyre praktikave të kriju-



ara tashmë nga organet e drejtësisë, standardet e krijuara nga vettingu, përbëjnë gjithashtu një model të mirë dhe plotësues të procedurave që ne ndjekim sot. Natyrisht, standardet e zbatuara nga procesi i vettingut, i cili ishte një proces sui generis, i përkohshëm dhe i jashtëzakonshëm, nuk mund të përdoren si një mjet zëvendësues i proceseve të punës, që ne ndjekim, që nga ngritja e institucioneve të drejtësisë. Por, përthithja e praktikave më të mira të zbatuara nga vetting, i shërben jo thjesht rritjes së performancës së sistemit të drejtësisë, por edhe konsolidimit të standardeve më të mira tona të përbashkëta.“

**Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në tryezën e diskutimit “Procesi i vettingut dhe efektet e tij drejt një gjyqësori të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm në**

**Shqipëri” .**

Të nderuar zotërinj Ambasadorë z. Gonzato dhe z Vos!

Të nderuar pjesëmarrës !

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë, për të shprehur disa konsiderata në lidhje me dokumentin e hartuar në kuadër të veprimtarisë së organeve të vettingut në Shqipëri.

Duke mbajtur në konsideratë faktin, se qëllimi i këtij dokumenti është përmirësimi i debatit mbi politikat dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë, e vlerësoj në mënyrë maksimale zhvillimin e aktiviteteve të tilla, të cilat nxisin diskutimet e drejtpërdrejta për ato çështje, të cilat kërkojnë një



vëmendje të veçantë dhe një analizë të thelluar e cilësore në kuadër të trajtimit dhe implementimit të tyre.

Qe prej ngritjes së organeve të reformuara të drejtësisë dhe në vazhdim, proceset e rekrutimit, karrierës dhe llogaridhënies së magistratëve po implementohen nga këto organe, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, që i rregullojnë ato. Veç këtyre praktikave të krijuara tashmë nga organet e drejtësisë, standardet e krijuara nga vetingu, përbëjnë gjithashtu një model të mirë dhe plotësues të procedurave që ne ndjekim sot. Natyrisht, standardet e zbatuara nga procesi i vetingut, i cili ishte një proces sui generis, i përkohshëm dhe i jashtëzakonshëm, nuk mund të përdoren si një mjet zëvendësues i proceseve të punës, që ne ndjekim, që nga ngritja e institucioneve të drejtësisë. Por, përthithja e prak-

tikave më të mira të zbatuara nga veting, i shërben jo thjesht rritjes së performancës së sistemit të drejtësisë, por edhe konsolidimit të standardeve më të mira tona të përbashkëta.

Ky proces transferimi i këtyre praktikave dhe standardeve është delikat dhe kërkon jo vetëm analiza të kujdesshme, por dhe një plan masash të koordinuara, si në aspektin rregullator apo edhe në atë administrativ. Kërkon një analizë të kujdesshme në lidhje me kompetencat e secilit organ, në kuadër të përfshirjes së këtij transferimi në aspekte të kontrollit të aseteve, integritetit apo profesionalizmit. Këtij procesi i shërben edhe raporti i paraqitur sot nga ekspertët e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Është një dokument i konsiderueshëm, i cili përmban një sërë gjetjesh të karakterit teknik, në lidhje me proce-

durat e standardet dhe nxjerr në pah një sërë problematikash. Këto çështje janë ngritur në nivel diskutimi dhe çmoj, se përbëjnë një udhërrëfyes të mirë për diskutimin mbi këto problematika të konstatuara, si dhe një pikënisje për këtë proces që po flasim. Një pasqyrë e tillë teknike e sfidave të procesit të vettingut i shërben patjetër përmirësimit të standardeve dhe për pasojë edhe unifikimit të praktikave të institucioneve.

Nuk do doja të ndalesha në proceset e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me aplikimin e praktikave më të mira të vettingut, pasi mendoj se nuk është ky rast, por dëshiroj të theksoj edhe njëherë në fund, se zhvillimi i këtij procesi mbi huazimin e modeleve apo standardeve më të mira të zhvilluara nga ana e organeve të vettingut, kërkon një vëmendje dhe kujdes të shtuar nga ana e institucioneve të drejtësisë, për t'i shërbyer unifikimit të praktikave të instituci-

oneve tona dhe konsolidimit të praktikave tona të përbashkëta.

Faleminderit!





## ORIENTIMI I ANKUESVE PËR KOMPETENCAT E ILD

Që prej nisjes së funksionimit e deri në publikimin e këtij buletini, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë konfirmuar 7199 ankesa nga qytetarë dhe institucione të ndryshme. Në kohë të ndryshme e në mënyrë sistematike, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u ka dhënë përgjigje qytetarëve rreth pyetjeve që kanë patur mbi ankesën e tyre, vendim-marrjen, kohën e shqyrtimit të ankesës, ndaj kujt nuk duhet bërë ankesë, apo edhe arsyen e arkivimit të ankesës.

Bazuar në procesin e shqyrtimit të ankesave, sjellim në vëmendje se sic është e parashikuar në ligj, ILD nuk është është kompetente për të shqyrtuar ankesat ndaj kancelarëve, ndihmësve ligjorë,


kryesekretarit të gjykatës, sekretarëve gjyqësorë, ftuesve, nëpunësve të tjerë të administratës gjyqësore, oficerëve të Policisë Gjyqësore, avokatëve apo përmba-ruesve shtetërorë ose privatë, apo subjekte të tjera që marrin pjesë në një proces hetimor apo gjyqësor.

Edhe në këtë numër të buletinit mujor të ILD-së, sjellim sqarime sa më shteruese të proceseve të punës, duke ilustruar grafikisht përgjigjet për pyetjet e shpeshta, si për shembull “A është marrë ankesa...”, “Sa kohë i duhet ILD-së për shqyrtim...”, “Cilat janë kushtet për pranimin e ankesës nga ILD”, e deri tek “Pse është arkivuar ankesa ime”.

**A ËSHTË MARRË ANKESA IME NGA ILD?**

Me të marrë ankesën tuaj, Inspektori i Lartë Gjithashtu, në rastet se ankesa juaj nuk i Drejtësisë, brenda 5 ditëve, ju konfirmon është objekt i veprimtarisë së ILD-së, njësia me shkrësë marrjen e saj. Ky proces quhet përgjegjëse e ILD-së, e përcjell ankesën tuaj konfirmimi i ankesës.

pranë institucionit kompetent, duke ju venë në dijeni edhe juve.

**A ËSHTË MARRË  
ANKESA IME NGA  
ILD?**

**SA KOHË I DUHET ILD-SË PËR TË SHQYRTUAR ANKESËN TIME?**

Pasi është konfirmuar marrja e ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka afat (tre muaj nga marrja e saj, për ta shqyrtuar e për të marrë informacion dhe analizuar këtë informacion, në mënyrë që të konfirmohet vërtetësia e pretendimeve.

Shqyrtimi siguron që ankesa plotëson kushtet, që ka vendosur ligji për të qenë e pranueshme. Por për shkak të ngarkesës së punës në raport me burimet njerëzore që disponon ILD-ja, ky proces mund të kërkojë më shumë kohë, pasi ILD respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese sipas kriterëve që lidhen me:

- datën e dorëzimit;
- tipologjinë apo urgjencën e trajtimit;
- afatet e parashkrimit të ankesës.

**Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë:**


- arkivimin e ankesës, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriteret për të qenë e pranueshme;
- të verifikojë pretendimet në ankesë kur ka të dhëna të paplota ose të paqarta, nga burime të ndryshme (organe të tjera; me subjektin e hetimit disiplinor; kryetarin a drejtuesin e organit ku ushtron detyrën magjistrati etj) apo të kërkojë sqarime a dokumentacion tjetër nga ankuesi;
- të fillojë hetimin, kur nga analizimi i të dhënave ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer.

**Shqyrtimi siguron që ankesa plotëson kushtet, që ka vendosur ligji për të qenë e pranueshme. Por për shkak të ngarkesës së punës në raport me burimet njerëzore që disponon ILD-ja, ky proces mund të kërkojë më shumë kohë, pasi ILD respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese sipas kriterëve.**



SA KOHË I DUHET ILD-SË PËR TË SHQYRTUAR ANKESËN TIME?  
(GRAFIKISHT)

SA KOHË I DUHET **ILD-SË** PËR TË SHQYRTUAR ANKESËN TIME?



**CILAT JANË KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKESËS NGA ILD?**

- Mënyra e paraqitjes së ankesës: Pra nëse ankesa është e paraqitur me shkrim.
- Paraqitja e të dhënave të subjektit: Emri, mbiemri dhe adresa juaj, si edhe nëse kërkon ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit tuaj.
- Përshkrimi i fakteve dhe rrethanave për të cilat ankoheni.
- Emri, mbiemri i gjyqtarit, apo prokurorit, bashkë me Gjykatën, apo Prokurorinë ku ka ushtruar funksionin, në kohën kur ka ndodhur rrethana apo fakti ndaj të cilit ankoheni.
- Nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur brenda 5 viteve nga momenti i dorëzimit të ankesës.
- Sjellja e magjistratit që nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.
- Sjellja e magjistratit, e parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur.
- Sjellja e magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur ka ndodhur rrethana, apo fakti për të cilin ankoheni.
- Nëse në përmbajtje të ankesës nuk ka elementë abuzivë, ankesa nuk është haptazi e pabazuar, ose e përsëritur nga i njëjti ankues.

**PSE ËSHTË ARKIVUAR ANKESA IME**

- Nëse njëri prej ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës (referoju “Cilat janë kushtet për pranimin e ankesës”) nuk plotësohen, atëherë Inspektori i Lartë i drejtësisë nxjerr vendimin për arkivimin e ankesës.
- Ju do të njoftoheni për vendimin e arkivimit të ankesës dhe për të drejtën tuaj për t’u ankimuar.

## CILAT JANË KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKESËS NGA ILD? (GRAFIKISHT)

# CILAT JANË KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKESËS NGA ILD?



### PSE ËSHTË ARKIVUAR ANKESA IME ?

✦ NËSE NJËRI PREJ OSE MË SHUMË NGA KRITERET E PRANUESHMËRISË SË ANKESËS (**REFEROJU "CILAT JANË KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKESËS"**) NUK PLOTËSOHEN, ATËHERË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NXJERR VENDIMIN PËR **ARKIVIMIN E ANKESËS.**



📄 JU DO TË NJOFTOHENI PËR VENDIMIN E ARKIVIMIT TË ANKESËS DHE PËR TË DREJTËN TUAJ PËR T'U ANKUAR.

## NDAJ KUJT NUK MUND TË PARAQES ANKESË NË ILD?

ILD nuk është kompetente për të shqyrtuar marrin pjesë në një proces hetimor apo ankesat ndaj kancelarëve, ndihmësve ligjorë, gjyqësor.

kryesekretarit, sekretarëve gjyqësorë, ftuesve, nëpunësve të tjerë të administratës Ankesat ndaj këtyre zyrtarëve duhet të paraqiten pranë autoriteteve përkatëse, që janë avokatëve apo përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë ose privatë, apo subjekte të tjera që referuar ligjit të posaçëm.

## NDAJ KUJT NUK MUND TË PARAQESËSH ANKESË NË ILD

KANCELARË DHE ADMINISTRATA GJYQËSORE



OFICERË TË POLICISË GJYQËSORE




AVOKATË DHE PËRMBARUES GJYQËSOR



SUBJEKTE TË PËRFSHIRA NË HETIME



FTUES DHE NËNPUNËS TË TJERË GJYQËSORE



**📌 Ankesat ndaj këtyre kategorive duhet të paraqiten pranë autoriteteve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi**

## MARSI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Mars 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **172 ankesa të depozituara nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Mars 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p>67 vendime nga 129 praktika të trajtuara</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 53 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar</li> <li>• 14 vendime arkivimi pas Verifikimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 17 vendime verifikimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 vendim fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrate (gjyqtare)</li> <li>• 2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtar)</li> </ul>

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- \* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- \* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- \* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,


në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Mars** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **9 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit **Mars 2025**, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ ka pritur **37** ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ ka realizuar **21** telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohet nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit [amanta.jasa@ild.al](mailto:amanta.jasa@ild.al).

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Mars 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **15 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).



ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted

Marta Kos @MartaKosEU

Very good meeting with independent justice institutions, which enable safe and secure Albania and Europe.

I commended their commitment to tackle corruption and organised crime and expressed the EU firm support to their role and working methods, in particular to SPAK.

It is important to engage in building independent and functioning judicial system, but even more so to instil respect of the rule of law.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD\_Albania

"Standardet e zbatuara nga procesi i vettingut që ishte një proces sui generis i përkohshëm dhe i jashtëzakonshëm nuk mund të përdoren si një mjet zëvendësues i proceseve të punës, që ne ndjekim, që nga ngritja e institucioneve të drejtësisë por..."

Translate post



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD\_Albania


Përpunimi javor i ankesave #ILD

- ✓ 7161 të konfirmuara
- ✓ 5794 Ankesa të trajtuara
- ✓ 1367 Ankesa në proces trajtimi
- ✓ 173 Ankesa në proces verifikimi

👉 Më shumë ild.al

📄 Si të bëj ankesë? ild.al/sq/si-pranohen...

👉 Duam mendimin tuaj ild.al/sq/ankete/



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD\_Albania


Përpunimi javor i ankesave #ILD

- ✓ 7115 të konfirmuara
- ✓ 5775 të trajtuara
- ✓ 1340 në proces trajtimi
- ✓ 174 në proces verifikimi

👉 Më shumë ild.al

? Keni pasur eksperiencë me ne? ild.al/sq/ankete/

👉 Si të ankoem në #ILD? ild.al/sq/si-pranohen...



## Mars 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD




## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin  
prezantues të ILD*



**Më skano!**